

VENDIM
Nr.1027, datë 8.10.2009

PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 3.2.2009, PËR ÇËSHTJEN NR.12306/04 “NURI KUNDËR SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të paragrafit të parë të nenit 46 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, ratifikuar me ligjin nr.8137, datë 31.7.1996 “Për ratifikimin e konventës europiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 12 të ligjit nr.10025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, datë 3.2.2009, për çështjen nr.12306/04 “Nuri kundër Shqipërisë”, në shumën 76 500 (shtatëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind) euro, si dhe pagesën e tatimit mbi të ardhurat për dëmshpërblimin, në masën 10 për qind të kësaj shume.

2.Autoriteti përgjegjës për ekzekutimin e këtij vendimi është Ministria e Financave dhe afati, brenda të cilit duhet kryer ky ekzekutim, është data 7.10.2009.

3.Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

4.Shuma e përcaktuar si detyrim, në pikën 1 të këtij vendimi, të depozitohet në njërën nga bankat e nivelit të dytë, në emër të ankuseses znj.Tefta Nuri, dhe të konvertohet në lekë, me kursin e këmbimit të bankës, ku është depozituar shuma, në datën e çeljes së llogarisë.

5.Pagimi i shumës së depozituar sipas pikës 4 të këtij vendimi, në favor të ankuseses, znj.Tefta Nuri, të bëhet nga Ministria e Financave, pas paraqitjes së të gjithë dokumentacionit ligjor, të nevojshëm për kryerjen e pagesave nga Buxheti i Shtetit.

6.Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha